



AKT- THEMELIMI

I

SHOQERISE PRIVATE TREGETARE DHE PRODHUESE ME PERGJEGJESI TE

KUFIZUAR " FITORJA" SHPK

Ne Tirane, sot me date 1.4.1994 (nentedhjete e kater) u i nenshkruari SHYQERI BALLA, i biri i Rakipit dhe i Fbties i datelindjes 1949, lindur ne Llukallesh dhe me banim ne Shupenze Bulqize, me cilesine e ortakut te vetem, me vullnetin tim te lire e te plote, vendosa te krijoje, shoqerine private tregetare dhe prodhuese me pergjegjesi te kufizuar "FITORJA2 SHPK.

M Y R J E

Ne kuptim te ketij akti themelues, ortakut i vetem SHYQER BALLA eshte themeluesi i shoqerise private tregetare dhe prodhuese "FITORJA SHPK.

Qellimi i ketij akti themelues eshte krijimi i Shoqer Tregetare e Prodhuese me Pergjegjesi te Kufizuar "FITORJA" SHPK me qender ne Shupenze Bulqize.


Shoqeria private tregetare dhe prodhuese "FITORJA" S Shupenze rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me aktin e themelimit statusin e saj, me ligjin Nr.7512 date 10.8.1991, Kodin Tregetare (Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992) dhe akte te tjera te legjislacionit shqiptare.

O B J E K T I

Objekti i veprimtarise private te Shoqerise "FITORJA SHPK do te jete aktiviteti i gjithesaneshem ne fushen e tregetit dhe prodhimit me shumice e pakic, import eksport brenda dhe jashte vendit te prodhimeve te ndryshme i percaktuar hollesishte ne statutin e Shoqerise, bashkangjitur ketij akti.

A F A T I I V E P R I M T A R I S E

Veprimtaria e Shoqerise do te jete efektive nga dita e reg. istrimit ne regjistrin Tregetare prane Gjykates se Rrethit Tirane, dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organet kopetente Aktiviteti privat do te zhvillohet me nje afat pacaktuar mbi 10 vjet.



KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltare i Shoqerise "FITORJA" SHPK Shupenze perbehet nga kontributi fillestare i ortakut te vetem themelues Z;SHYQERI BALLA i cile arrin ne veleren prej 100 000 leke.

Ortaku i vetem themelues ose persona te autorizuar prej tij kane te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve periodike ose vjetore, te perfitojne perqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shteterore, sigurimet shoqerore etj.

Per shkeljete ndryshme e te mundeshme te parashikuara ne statut ortakut themelues mund te marre mas nadeshkimore ndaj kujdo qe demton pasurine e shoqerise.

JURIDIKSINI

Shoqeria " FITORJA" SHPK e ka qendren e saj ne Shupenze Bulqiz. Te gjitha mosmarveshjet me personat juridike e fizik, vendas a te huaj si dhe organet shteterore, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten zgjidhja e tyre mund te hehet nga Gjykata e Rrethit Tirane.

T H E M E L U E S I

SHYQERI BALLA

S T A T U T I

I

SHOQERISE PRIVATE TREGETARE DHE PRODHUESI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"FITORJA" SHPK

Ne baze te ligjit Nr.7512 date 10.8.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit", te Kodit Tregetar dhe akteve te tjera ligjore, ne Tirane sot me date 1.3.1994, shtetasi SHYQERI BALLA, banues ne Shupenze Bulqize, me vullnetin e tij te lire e te plote, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, vendosi te krijojte Shoqerine Private Tregetare dhe Prodhuese me Pergjegjeshi te kufizuar "FITORJA" SHPK Shupenze Bulqize.

K R E U I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Shoqeria me Pergjegjeshi te Kufizuar "FITORJA" SHPK Shupenze Bulqize eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijeve te percaktuar ne Ligjin Nr.7512 date 10.8.1991, Kodin Tregetar dhe akteve te tjera ligjore.

Neni 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

Neni 3

Themeluesi i Shoqerise ne kete sipermarrje ka derthur kapitalin e tij, me qellim qe te perfitoje te ardhura qe mund te vijne nga veprimaria private si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestare.


Neni 4

Shoqeria "FITORJA" SHPK Shupenze Bulqize, eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Gjykatën e rrethit te Tiranes dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kompetente.

EMRI QENDRA TERRITORI

Neni 5

Emertimi i Shoqerise do te jete:



Shoqeria Private Tregtare dhe Prodhuese me Përgjegjësi të Kufizuar
"FITORJA" SHPK

Neni 6

Selia e Shoqërisë është në Shqipëri dhe në Shqipëri
Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj dhe të çelë
filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

O B J E K T I

Neni 7

Objekti i veprimtarisë dhe aktiviteti i kësaj shoqërie private
tregtare dhe prodhuese do të jetë:

Tregtimi me shumicë e pakicë, import eksport, brenda dhe jashtë
vendit të artikujve të ndryshëm:

- * Industriale, ushqimore, bujqësore dhe blektorale
- * Fruta perime
- * Pije alkoolike dhe freskuese
- * Pajisje elektro shtëpijake
- * Makineri e pajisje, ojese këmbimi
- * Materiale ndërtimi, pajisje hidro-sanitare
- * Lende druri dhe hekurishte .
- * Dru zjarri
- * Transport mallrash e pasagjërësh brenda dhe jashtë vendit.
- * Përpunimi i produkteve bujqësore dhe blektorale
- * Si dhe çdo aktivitet tjetër që veçmas ose së bashku me ato
të përmendura më sipër do të konsiderohen të përkatshme për rritjen
dhe zhvillimin e Shoqërisë;

A F A T I I V E P R I M T A R I S E

Neni 8

Aktiviteti i Shoqërisë do të zhvillohet me një afat të paktën
të afatit 10 vjet.

Neni 9

Shoqëria është e detyruar të mos ndryshojë destinacionin e
saj.

Ndryshimi i destinacionit të veprimtarisë ekonomike financiare
brenda 2 vjetësh mund të bëhet me leje të organeve përkatëse.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 10

Kapitali themeltare i shoqerise "FITORJA" SHPK perbehet nga konti i fillimit te themeluesit te shoqerise ne vleften prej 100 000 lekesh.

Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise.

Neni 11

Transferimet e kapitalit themeltare duhet te vertetohen me akt noterial. Shoqeria apo te tretet duhet te respektojne keto transferime sa ti behen te ditura asaj.

Neni 12

Pjeset e kapitalit themeltare jane te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato mund tu kalojne, bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve;

Neni 13

Pjeset e kapitalit themeltare mund ti transferohen edhe persona te trete, qe nuk bejne pjese ne Shoqeri me pelqimin e themeluesit te Shoqerise. Ne rast te shtimit te numerit te ortakëve, qe perfaqsojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltare.

Neni 14

Ne rast te shtimit te numerit te ortakëve, me marveshje, pjeset kapitalit themeltare jane lirisht te transferueshme ndermjet tyre.

DREJTIMI ADMINISTRATIVE

Neni 15

Shoqeria "FITORJA" SHPK Shupenze Bulqize, do te jete si administrator z. SHYQERI BALLA. Themeluesi i shoqerise ka ne kopetence te caktoj si administrator edhe persona te tjere te cilet huk kane cilesine e ortakut.

Neni 16

Ne mardhenje me te tretet administratori angazhon shoqerine mepermjete akteve, qe jane ne perputhje me objektin e saj. Ne rastet kur administratori eshte i emeruar nga themeluesi i shoqerise, kryen te gjith veprimet e administrimit te shoqerise, me perjashtim te atyre qe jane me kopetence te themeluesit te shoqerise.



Neni 17

Ortaku i vetm themelues ka ne kopetence :

* Te miratoje programin e shoqerise, te hartoje raportin e administrimit, inventaret, llogarite vjetore, te cilat hartohen brenda nje afati 6 mujor, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

* Vendos per shperberjen e shoqerise.

* Vendos per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.

* Rregullon mardhenjet e punesimit e te shperblimit brenda shoqerise.

* Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shteterore personale juridik dhe fizik vendas a te huaj.

* Etj.

Neni 18

Ne rast se administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator i zgjedhur posacerishte nga ortaku themelues, ky i fundit miraton aktet administrimit brenda afateve te mesiperme dhe ka te drejte te informohet personalishte per veprimtarine e shoqerise si dhe te njihet me llogarit dhe dokumentat e shoqerise.

Neni 19

Administratori humbet detyren e ngarkuar ne rast te prishjes se shoqerise ose kur shkarkohet nga ortaku i vetem themelues i shoqerise. Ne rastin e fundit, shkarkimi i administratorit behet ne baze te nje akti me shkrim te themeluesit te shoqerise. Ne rast se shkarkimi behet pa te drejte ai le shkak per demshperblime financiare.

K R E U I I

MARDHENJET EKONOMIKE FINANCIARE

Neni 20

Shoqeria "FITORJA "SHPK mund te lidhe kontrata me sektoret shtetore, drejte per drejte me tregun e lire si dhe me persona juridike e fizik vendas a te huaj, sipas legjislacionit ne fuqi per eksport importi

Neni 21

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqsohet nga SHYQERI BALLI ose persona te tjere te autorizuar prej tij.

Neni 22

Te drejt, t dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te



detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

Neni 23

Sipas rregullave te caktuara nga ministria e Financave dhe agjencite tjera ligjore, shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqerore etj. Sipas ligjeve te tatimit mbi fitimin percaktohen tatimet per veprimtarine tregtare te shoqerise. Shoqeria ka te drejte te cele llogari likujduese prane bankave te vendit, te huaja ne Shqiperi dhe te kryej veprimet e likuidimit nepermjet tyre.

Neni 24

Shoqeria ka te drejte te ransferoje jashte shtetit kapitalin dhe pjesen e saj te fitimit ne valute. Per pjesen e fitimit qe transferohet jashte shoqeria paguan nje tatin 10 perqinte te shumes se fitimit qe transferohet.

Neni 25

Per pasqyrimin e aktivitetit tregtare administratori ose persona te tjere te caktuar nga ortaku i vetem themelues, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe regjistrat perkates sipa ligjit te vecante.

Neni 26

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron ne muajin dhjetore te cdo viti. Administratori eshte i detyruar te paraqese bilance periodike, bilance vjetore si bashku me deklaraten e fitimeve dhe humbjeve dhe ti deponize ato ne organin financiar te juridiksonit perkates, ku ushtron aktivitetin shoqeria.


K R E U I I I I MARDHENJET E PUNESIMIT

Neni 27

Themeluesit shoqerise vendos per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakeve dhe personave te tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e shoqerise "FITORJA" SHPK.

Neni 28

Mardhenjet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates qe lidhet lirishte midis paleve. Kontrata leshohet nga administratori i shoqerise mbasi te jete mare me pare pelqimi i themeluesit te shoqerise



ose nga vet ortaku themelues qe ka dhe detyren e administratorit.

Neni 29

Marrja ne pune nga pune dhenjesi behet me regjistrimin e punojesve ne librin e punes se shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e pu te juridiksionit ku e ushtron aftivitetin shoqeris.

Neni 30

Ortaku i vetem, ortaket ne rast se shtohet numeri i tyre, administratori dhe punonjesit e tjere te shoqerise jane te detyruar te respektojne disiplinën e punes dhe mbajne pergjegjesi per thyerjen e saj.

Neni 31

Kontrata e punes mund te lidhet me ose pa afat te caktuar, sipas kriterëve te caktuara nga ortaku i vetem themelues, ose ortaket kur janë disa te tille dhe ne mungese te parashikimeve ne kontrate sipas ligjeve te shtetit shqiptare.

Neni 32

Mdryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortaku i vetem themelues z. Shyqeri Balla. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljeve disiplinore ose me vet kerkesen e te interesuarit.

Neni 33

Punonjessi qe largohet ose transferohet ne nje pune tjeter duhet te beje dorezimet e deyres ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete likujduar detyrimet materiale dhe monetare. Akti i mesiper mbahet nga administratori i shoqerise.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 34

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurim shoqerore, etj, kalojne ne pronesia te ortakut te vetem themelues.

Neni 35

Shperblimi per administratorin dhe personat e punesuar ne v printarine e shoqerise "FITORJA." SHPK caktohet sipas kontrates se punes. Mdryshimi ne page vendoset nga themeluesi i Shoqerise.



Neni 36

Shoqeria perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te saj fillestare ne kapitalin base.F

Neni 37

Fitimi qe do te shperndahet perbehset nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbitur ose shtuar numerat respektive te humbjeve apo fitimeve te mbartuara nga vitet e meparshme.

Neni 38

Kur pushon aktiviteti i shoqerise, kapitali i mbetur, pasi shlyer te gjitha detyrimet ndahet midis ortakëve sipas kontributit te cecilit ose i mbetet ortakut te vetem themelues kur nuk ka te tjere.

Neni 39

Fitimi i mbetur kalon ne pronesi te ortakut te vetem themelues pasi jane shlyer te gjitha detyrimet tatimore si dhe pagesat e mundeve me per ounonjessit e shoqerise.

SHIFERIMET E SHOQERISE

Neni 40

Ne rast se kapitalet e shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltare, ortakut themelues vendos brenda kater muajve nga dita e konstatimit mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise dhe mund te kerkoje ne gjykate prishjen e saj.

Neni 41

Gjykata mund t'ia kshperk afroje shoqerise nje afat maksimal prej 6 muaj per te rregulluar gjendjen. Ajo nuk mund te prishe shoqerine ne rast se ky rregullim eshte bere ne ditën ne te cilen ajo mbledhet per te marre vendim.

Neni 42

Ne rast se shoqeria nuk priset, detyrohet te zvogeloje kapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbkeve qe ka mbetur pa mbuluar, duke patur parasysh qe shumën e kapitalit te mbetur te jete mbi 100 000 leke.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 43

Themeluesi ne rastin e shtimit te numerit te ortakëve ka te drejt te beje ndryshimet e nevojeshme ne statut si dhe te hartoje dhe kontrat e perbashketme ortakët e tjere,duke bërë ndryshimet e nevojeshme ne regjistrin tregëtare prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 44

Komaroveshjet e shoqerise ne bashkenje me persona juridike e fiz. vendos a te kusht,sgjiden me mirekuptim,ne te kunderten,kur kjo nuk arrhet,sgjiden nga Gjykata e rrethit Tirane.

Neni 45

Persa nuk eshte shprehur ne kete staut i referohet ligjes ligjes Nr.7512 date 10.8.1991,Kodit Tregëtare te Republikës se Shqiperise si dhe qdo akti tjetër ligjor te legjislativitetit shqiptarë.

Neni 46

Statuti perpilohet ne disa kopje per tju dorëzuar organeve kopet te.Nje kopje e tij mbetet si pjese e dokumentacionit te te rimit te Shoqerise me Pergjegjesi te kufizuar "FITORJA " SHPK Shupenze Bulqise.

U nenshkrua ne Tirane sot,me date 1.4.1994

ORTAKU I VETEM

Shyqeri Balla

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA

Nr. 6324 rep
Nr. 8888 39/3 kol

VERTETIM

Sot,me date 1.4.1994(nentedhjete e kater) u paraqit personalite para meje noteres ne zyren e noterise Tirane,Shyqeri Balla ortak i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "FITORJA "SHPK,'madhore e mzetesi te plate juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u shirova nga leternjoftimi i tij persona, i cili deklaroi se sa ne siper eshte akti i themelimit dhe statutit i Shoqerise, i perpiluar jashte kesaj zyre ne vullnetin e tij te lire e te plate, nenshkruhet rregullisht perpara meje dhe une noterja e vertetoi kete sipas ligjes .



NOTERE
(Suprae Sp...